

VENDIM
Nr. 699, datë 18.11.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E LLOJEVE TË DOKUMENTACIONIT PROVUES,
PROCEDURAVE TË DEPOZITIMIT, MËNYRËS SË SHQYRTIMIT DHE
VLERËSIMIT TË DOKUMENTACIONIT, LLOJEVE TË PROGRAMEVE TË
TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM, PERIODICITETIT TË TRAJNIMIT, SI DHE
MËNYRËS SË VLERËSIMIT TË AFTËSIVE TË PËRFITUARA GJATË
TRAJNIMIT PËR AGJENTIN E TOKENIT DIGJITAL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 29, të ligjit nr. 66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky vendim ka si objekt përcaktimin e llojit të dokumentacionit provues, mënyrës së shqyrtimit e të vlerësimit të dokumentacionit, si dhe llojeve të programeve të trajnimit të detyrueshëm, periodicitetit të trajnimit e mënyrës së vlerësimit të aftësive të përfituara gjatë trajnimit për subjektet që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agjent i tokenit digjital.

Neni 2
Fusha e veprimtarisë

Ky vendim zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë, që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si agjent i licencuar i tokenit digjital në Republikën e Shqipërisë, për klientë që ndodhen brenda territorit të saj ose nga Republika e Shqipërisë, për klientë që ndodhen jashtë saj.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë vendim, përveç përkufizimeve të dhëna në nenin 3, të ligjit nr.66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Autoritet”**, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;
- b) **“e-Learning”**, programet e trajnimit *online* që mundësojnë pjesëmarrjen në distancë;
- c) **“Fushë e ekspertizës”**, të gjitha fushat e trajnimit të përcaktuara në programin e detyrueshëm të trajnimit, sipas nenit 7, të këtij vendimi;
- ç) **“Kërkesë për njohje”**, çdo kërkesë për njohjen e një ose më shumë PTD-ve, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 11, të këtij vendimi;
- d) **“Ligji”**, ligji nr.66/2020, “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”;
- dh) **“Njohje”**, procedura e vlerësimit të një PTD-je me qëllim garantimin e përshtatshmërisë së saj për trajnimet e ofruara;

e) **“Personel kyç”**, çdo person fizik/individ, i cili mban një ose më shumë nga funksionet e mëposhtme në shoqërinë e subjektit kërkues/agentit TD:

- i. drejtori i Departamentit të Administrimit të Rrezikut;
- ii. drejtori i Departamentit të Auditimit të Brendshëm;
- iii. drejtori i Departamentit të Financës;
- iv. drejtori i Departamentit të Parandalimit të Pastrimit të Parave;
- v. drejtori i Departamentit të Përputhshmërisë;
- vi. zyrtari përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

ë) **“Program i trajnimit të detyrueshëm (PTD)”**, të gjitha kurset, seminarët e trajnimit, të cilat kanë për qëllim certifikimin e njohurive dhe aftësive të subjekteve që ushtrojnë ose kërkojnë të ushtrojnë veprimtarinë si agent TD;

f) **“Tarifa e njohjes”**, tarifa që paguhet për marrjen e vërtetimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për kryerjen e një ose më shumë PTD-je;

g) **“Periudhë trajnimi”**, periudha kohore përgjatë së cilës duhet të kryhet PTD-ja.

KREU II

LLOJET E DOKUMENTACIONIT PROVUES DHE PROCEDURA E DEPOZITIMIT, SHQYRTIMIT DHE VLERËSIMIT TË TIJ

Neni 4

Llojet e dokumentacionit provues

1. Krahas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, subjekti kërkues për licencë agjenti TD, për të provuar se ka aftësitë dhe njohuritë e duhura teknike dhe ligjore për të ushtruar veprimtarinë e lidhur me agentët TD, duhet të depozitojë edhe dokumentacionin provues lidhur me kryerjen e programeve të trajnimit të detyrueshëm, si më poshtë vijon:

- a) vërtetimin për kryerjen e PTD-së, sipas përcaktimeve të nenit 11, të këtij vendimi;
- b) mandatin e pagesës së tarifës së njohjes së PTD-së;
- c) fotokopjen e kartës së identitetit të punonjësve, të cilët u janë nënshtruar programeve të trajnimit të detyrueshëm.

Neni 5

Procedura e depozitimit të dokumentacionit provues

1. Dokumentacioni provues i përcaktuar në nenin 4, të këtij vendimi, depozitohet pranë Autoritetit në rrugë shkresore ose dorazi, brenda periudhës përkatëse të trajnimit, të përcaktuar në nenin 10, të këtij vendimi.

2. Kërkesa përkatëse nga ana e subjektit kërkues për vërtetimin e kryerjes së PTD-së mund të përfshijë një ose më shumë PTD.

Neni 6

Mënyra e shqyrtimit dhe e vlerësimit të dokumentacionit provues

1. Dokumentacioni provues merret në dorëzim nga Autoriteti, i cili, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve kalendarike vlerëson nëse ky dokumentacion është në përputhje me parashikimet e nenit 4, të këtij vendimi.

2. Nëse dokumentacioni i dorëzuar ka të meta ose nuk është i plotë, Autoriteti i kërkon subjektit të interesuar plotësimin dhe/ose saktësimin e tij brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike.

3. Pas shqyrtimit e vlerësimit të dokumentacionit provues, Autoriteti njofton subjektin lidhur me vendimin për miratimin ose jo të kërkesës së tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e këtij vendimi.

4. Ndaj vendimit të Autoritetit, subjekti i interesuar mund të ushtrojë të drejtën e ankimit pranë gjykatës kompetente që shqyrton mosmarrëveshjet administrative, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga e nesërmja e marrjes së vendimit.

KREU III PROGRAMET E TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM

Neni 7

Llojet e programeve të trajnimit të detyrueshëm

1. Programi i trajnimit të detyrueshëm përbëhet nga aktivitete trajnuese dhe edukative, të cilat janë njohur ose zhvilluar nga Autoriteti, me qëllim përmirësimin e detyrueshëm të aftësive dhe përditësimin e njohurive të subjekteve kërkuese dhe agentit TD.

2. PTD-të organizohen në disa lloje:

- a) kurse;
- b) seminare; dhe
- c) konferenca.

3. Kurset, seminarët dhe konferencat synojnë përmirësimin e përditësimin e vazhdueshëm të njohurive të subjekteve kërkuese dhe/ose agentit TD në fushën e tregjeve financiare, të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë, dhe kategorizohen në fushat, si më poshtë vijon:

a) ligjshmëria, përputhshmëria dhe çështjet rregullatore lidhur me teknologjinë e regjistrave të shpërndarë;

b) financa, duke përfshirë këtu inxhinierinë financiare të teknologjisë së regjistrave të shpërndarë;

c) teknologjia e informacionit dhe siguria kibernetike.

4. Lista e llojeve të PTD-ve të njohura aktualisht nga Autoriteti janë listuar në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Kjo listë përditësohet nga Autoriteti të paktën 1 (një) herë në vit, brenda muajit dhjetor.

Neni 8

Metodologjia e trajnimit të detyrueshëm

1. PTD-të zhvillohen në formën e leksioneve, kurseve dhe seminareve *online* nëpërmjet kurikulave, të cilat përbëhen nga tekste akademike, trajnime, *live streaming*, leksione të regjistruara, *e-Learning*.

2. Për metodologjinë e trajnimit, stafi akademik, i cili ofron PTD, duhet:

a) të zhvillojë një metodë ndërvepruese mësimdhënieje;

b) të bëjë përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajnimit teorik dhe atij praktik të çështjeve që janë objekt diskutimi, ku prioritet të kenë aspektet praktike;

c) të kujdeset për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jodominuese, duke u lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga ana e pjesëmarrësve;

ç) të ketë aftësinë për të kombinuar disa metoda të mësimdhënies (prezantimi verbal, prezantim me shkrim, puna në grup, pyetjet, përdorimin e mjeteve audiovizive etj.);

d) të ketë aftësi për të prezantuar materialin pa ndonjë mbështetje dokumentare e për të përgatitur materialet burimore të nevojshme, mbështetjen e aspekteve teorike dhe praktike, për të vëzhguar nivelin e duhur të ndërveprimit dhe mbështetjen e metodave të trajnimit, qëllimit e tematikës së prezantimeve dhe për të qëndruar brenda kohës së përcaktuar për një prezantim;

dh) të bashkëpunojë me pedagogët e tjerë që mund të jenë të përfshirë në të njëjtin trajnim ose tematikë.

Neni 9

Përzgjedhja e programeve të trajnimit të detyrueshëm

1. Subjektet kërkuese për licencë ose agent TD kanë detyrimin për të marrë pjesë në PTD, të cilat mbulojnë secilën prej fushave të përcaktuara në nenin 7, të këtij vendimi.
2. PTD-të duhet të ndiqen nga zyrtarët e agentit TD ose të subjektit kërkues, të listuar, si më poshtë vijon:
 - a) administratori;
 - b) anëtarët e këshillit mbikëqyrës/këshillit të administrimit;
 - c) personeli kyç.
3. PTD-të mund të zhvillohen brenda ose jashtë Shqipërisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Periodiciteti i trajnimeve të detyrueshme

1. Në përputhje me pikën 8, të nenit 29, të ligjit, agjenti TD dorëzon pranë Autoritetit, brenda muajit të parë të çdo viti kalendarik, certifikatat ose dokumentet përkatëse, që vërtetojnë pjesëmarrjen e përfundimit me sukses të PTD-së në secilën prej fushave të përcaktuara në nenin 7, të këtij vendimi.
2. Periudha e trajnimit për agentin TD fillon nga data e marrjes së licencës deri në:
 - a) fundin e vitit kalendarik;
 - b) dhe në vijim për çdo vit kalendarik pasardhës.
3. Autoriteti publikon listën e miratuar të PTD-ve, 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike përpara fillimit të çdo periudhe trajnimi. Kjo listë përditësohet periodikisht të paktën 1 (një) herë në vit.

Neni 11

Mënyra e vlerësimit të aftësive të përfituara nga PTD-ja

1. Pas përfundimit të PTD-së në secilën prej fushave të listuara në nenin 7 të këtij vendimi, subjekti kërkues ose agjenti TD dorëzon pranë Autoritetit kërkesën për t'u pajisur me vërtetimin e kryerjes së PTD-së, duke bashkëlidhur dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) certifikatën ose dokumentin përkatës, që vërteton përfundimin me sukses të PTD-ve të listuara në shtojcën 1, të këtij vendimi, në secilën prej fushave të përcaktuara në të;
 - b) listën e notave, në rast se është e aplikueshme;
 - c) mandatin e pagesës së tarifës së njohjes së PTD-së;
 - ç) fotokopje të kartës së identitetit të secilit pjesëmarrës në PTD, si dhe pozicionin e tyre brenda strukturës së shoqërisë së subjektit kërkues/agentit TD.
2. Autoriteti shqyrton kërkesën e dorëzuar sipas pikës 1 të këtij neni, dhe vendos, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve lidhur me pajisjen e subjektit me vërtetimin përkatës. Vërtetimi lëshohet në emër të subjektit kërkues ose të agentit TD, sipas rastit.
3. Kur subjekti ka përfunduar 1 (një) ose më shumë PTD, të cilat nuk janë të përfshira në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, Autoriteti e pajis subjektin me vërtetimin përkatës vetëm në rastet kur PTD-ja përmbush minimalisht kriteret e mëposhtme:
 - a) certifikata ose vërtetimi për përfundimin e studimeve të jetë lëshuar nga institucione të licencuara, të njohura/të akredituara apo institucione të autorizuar në vendin e origjinës;
 - b) programi mësimor i PTD-së të jetë i fokusuar në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë dhe të përfshijë 1 (një) ose më shumë nga fushat e përcaktuara në nenin 7 të këtij vendimi;
 - c) plani mësimor të përmbajë të paktën 20 (njëzet) orë mësimdhënieje;
 - ç) të ketë të punësuar të paktën 2 (dy) ekspertë në cilësinë e trajnuesve për secilën nga fushat që ofrohet PTD-ja, të cilët përmbushin këto kritere:

i. zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor” ose të barasvlefshme, në fushat përkatëse për të cilat ofrohet PTD-ja;

ii. kanë përvojë akademike për të paktën 3 (tre) vjet;

d) të ketë të paktën 20 (njëzet) pjesëmarrës të regjistruar në PTD-në përkatëse;

dh) ofruesi i PTD-së të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë në ushtrimin e veprimtarisë së mësimdhënies e të trajnimeve në 1 (një) ose më shumë nga fushat e përcaktuara në nenin 7, të këtij vendimi.

3. Agjenti i TD-së i licencuar dorëzon pranë Autoritetit vërtetimin për kryerjen e PTD-së për periudhën pararendëse të trajnimit brenda muajit të parë të çdo viti.

4. Në rastet kur një nga personat, i cili ka përfunduar me sukses PTD-në, largohet nga funksionet e përcaktuara në strukturën e shoqërisë së subjektit dhe ky i fundit nuk ka në strukturën e shoqërisë së tij individë të tjerë që kanë përfunduar trajnimin në ato fusha të caktuara, atëherë subjekti njofton Autoritetin, me shkrim, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e largimit të tij. Brenda 6 (gjashtë) muajsh nga data e largimit, subjekti kërkues ose agjenti TD plotëson vendin vakant, duke emëruar individë që kanë përfunduar me sukses PTD-të në fushën e caktuar.

5. Mospajisja me vërtetimin për kryerjen e PTD-së, në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, përbën shkak për refuzimin e kërkesës për licencimin ose revokimin e licencës së agentit TD.

6. Autoriteti ka të drejtë të bëjë verifikimet përkatëse për vërtetësinë dhe origjinalitetin e dokumenteve të dorëzuara nga subjekti kërkues.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 12 Të fundit

1. Ngarkohet Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1 LISTA E PROGRAMEVE TË TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM, TË NJOHURA NGA AUTORITETI I MBIQËQYRJES FINANCIARE

Ofruesi	Emri i PTD-së	Venndodhja	Ligjshmëria dhe çështje rregullatore	Financë	Teknologjia e Informacionit
<i>INSEAD</i>	<i>Blockchain Revolution Specialization</i>	<i>Online</i>			✓
<i>MIT Sloan</i>	<i>Blockchain Technologies: Business Innovation and Application</i>	<i>Online</i>			✓

<i>MIT Media Lab</i>	<i>Cryptocurrency</i>	<i>Online</i>	✓		✓
<i>University of Oxford</i>	<i>Oxford Blockchain Strategy Programme</i>	<i>Online</i>	✓	✓	✓
<i>LSE</i>	<i>Cryptocurrency & Disruption</i>	<i>Online</i>	✓	✓	✓
<i>NYU*</i>	<i>Fintech MBA*</i>	Nju-Jork, SHBA			✓
<i>SDA Bocconi</i>	<i>The Blockchain Journey</i>	<i>Online</i>			✓
<i>University of Nicosia*</i>	<i>Master of Science in Digital Currency*</i>	<i>Online</i>	✓	✓	✓
<i>AICPA</i>	<i>Blockchain Fundamentals for Accounting and Finance Professionals Certificate</i>	<i>Online</i>		✓	✓
<i>Consensys</i>	<i>Academy courses on blockchain</i>	<i>Online</i>			✓
<i>B9Lab</i>	<i>Ethereum Developer / Ethereum QA Engineer Course</i>	<i>Online</i>			✓
<i>INSEAD</i>	<i>Introduction to blockchain technologies</i>	<i>Online</i>		✓	✓
<i>Princeton University</i>	<i>Bitcoin and cryptocurrency technologies</i>	<i>Online</i>		✓	✓
<i>Wharton University of Pennsylvania</i>	<i>Fintech revolution executive education program</i>	<i>Online</i>		✓	✓
<i>Berkeley Executive Education</i>	<i>Berkeley Fintech education program</i>	<i>Online</i>		✓	✓
<i>University of Pennsylvania</i>	<i>Fintech foundation and applications</i>	<i>Online</i>		✓	

<i>Harvard Business School</i>	<i>Fintech Executive Education Program</i>	<i>Online</i>		✓	
<i>University of Cambridge</i>	<i>Fintech Innovation Executive Education Program</i>	<i>Online</i>		✓	
<i>University of Hong Kong</i>	<i>Fintech Professional Certificate Program</i>	<i>Online</i>		✓	✓

* Programet e trajnimit të detyrueshëm të ofruara nga *New York University* dhe *University of Nicosia* do të konsiderohen të njohura nga ana e Autoritetit, vetëm pasi diploma e përfituar nga subjekti t'u jetë nënshtruar procedurave të njohjes e të njësimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njohjen dhe njësimin e diplomave universitare.